



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1574 Prot.

Tiranë, më 25.08.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 115, datë 25.08.2026

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT NR. 80, DATË 22.05.2026 “PËR
MIRATIMIN E STRESS TESTIT (PROVË USHTRIMORE) PËR PËRBALLIMIN
FIZIKISHT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR NË “SHKENCA TË
LËVIZJES” DHE NË “FUSHAT E VEPRIMTARISË FIZIKE, TË SHËNDETIT DHE
REKREACIONIT”**

Mbështetur në nenin 3, 38, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenin 7 dhe 20 të Statutit të UST, Vendimin nr. 104, datë 24.08.2026 të Rektoratit, Senati

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1 të Vendimit nr.80, datë 22.05.2026 të Senatit Akademik si vijon:

Ishte: Fituesit e konkurseve të pranimi në programet e studimit Bachelor në “Shkenca të Lëvizjes” dhe në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit”, të paraqesin në fazën e regjistrimit dokumentin e kryerjes jashtë Universitetit të Sporteve të Tiranës të kontrollit “*Stress Test*” (Provë Ushtrimore) për të vijuar studimet në këto programe.

Bëhet: Fituesit e konkurseve të pranimi në programet e studimit Bachelor në “Shkenca të Lëvizjes” dhe në “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit” për vitin akademik 2026-2027, të paraqesin në Sekretarinë Mësimore Digjitale dokumentin e kryerjes jashtë Universitetit të Sporteve të Tiranës të kontrollit “*Stress Test*” (Provë Ushtrimore) deri në datën 30.01.2027 (para fillimit të sezonit dimëror të provimeve).

2. Ky Vendim është i vlefshëm për çdo vit akademik në vijim dhe i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

